



Konferenca e Dytë Shkencore, 12-13 Dhjetor

## SFIDAT E KLSH-SË NË AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Drinold Sema

Senior ICT Associate, UNICEF

e-mail: [drinisema@gmail.com](mailto:drinisema@gmail.com)

Erton Kaleshi, Lektor

Universiteti i Tiranës

e-mail: [ekaleshi@yahoo.com](mailto:ekaleshi@yahoo.com)

### ABSTRAKT

Auditimi i Teknologjisë së Informacionit në sektorin publik është një ndër fushat e reja që ka marrë rëndësi të veçantë këto vite për shkak të zhvillimit dixhital të futur në praktikat e punës gjatë dekadave të fundit. Përdorimi në zgjerim e sipër i pajisjeve dhe sistemeve kompjuterike në instancat shtetërore ka rritur ndjeshmërinë ndaj rreziqeve. Kjo sjell jo vetëm një risi për qeverisjen efikase të infrastrukturës dhe ruajtjes së të dhënave delikate nga ana e instancave të shtetit, por edhe për auditimin efikas të tyre nga audituesit.

Në këtë lloj këndvështrimi, me dëshirën dhe vullnetin e Shqipërisë për të qënë në linjë me zhvillimet e fundit të auditimit publik dhe të zbatojë praktikat rigoroze të provuara dhe miratuara në standartet ndërkombëtare, synojmë të sjellim një punim i cili ka në fokus të tij domosdoshmërinë e zbatimit të këtyre praktikave, vështirësitë që hasen dhe si mund të tejkalohen ato, sfidat në ngritjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të standardeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit, si edhe hartimin dhe zbatimin e metodologjive përkatëse nga ALSAI, duke u munduar të japim edhe linjat kryesore në të cilat duhet të përqendrohet puna e tij.

### Fjalët kyçe:

*Auditim publik, ALSAI, ICT, COBIT*